

Korrieri
+355 60 000 0000
keni një letër
nga gjykata
më telefono!

ABSURDI I NJOFTIMIT ME SHPALLJE NË GJYKIMIT RISHIKUESE

RAPORT MONITORIMI

Shtator 2023



QENDRESA
QYTETARE



NED

NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al

AUTOR
DHIMITËR ZGURO

Korrieri
+355 60 000 0000
keni një letër
nga gjykata
më telefono!

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE.....	2
2. GJYKIMI RISHIKUES DHE NJOFTIMI	3
2.1 Gjykimet rishikuese.....	3
2.1.1 Gjykimi në gjykatat e apelit	3
2.1.2 Gjykimi në Gjykatën e Lartë.....	3
2.2 Rëndësia e njoftimit në gjykimin rishikues	4
2.3.1 Njoftimi me shpallje në gjykatat e apelit	6
2.3.2 Njoftimi me shpallje në Gjykatën e Lartë.....	6
2.4 Problemet e njoftimit me shpallje.....	7
3.1 Gjykata Kushtetuese mbi njoftimin me shpallje në Gjykatën e Lartë 9	
3.2 GJEDNJ mbi njoftimin me shpallje në Gjykatën e Lartë	10
REKOMANDIME	11
BIBLIOGRAFIA	11

1. HYRJE

Kushdo, në referim të nenit 42, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 6, të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese dhe ligjore, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë, publik, brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e caktuar me ligj.¹ Një nga komponentët e kësaj të drejte kushtetuese është dhe e drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim. Afërmendsh, për nga natyra që kjo e drejtë ka, ajo u paraprin të tjerave pasi nuk mund të pretendohet për ushtrimin e të drejtave që një qytetar ka në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, nëse ai nuk njoftohet mbi datën dhe orën e seancës.²

Në kuadër të kësaj garancie kushtetuese dhe konventore, ligjvënësi ka parashikuar në ligjet proceduriale të gjykimit civil, penal dhe administrativ, jo vetëm llojet e njoftimit të akteve, por edhe rregullat mbi kryerjen e njoftimit të akteve kundrejt palëve në proces.

Kështu si rregull, në gjykimin në shkallë të parë, ligjvënësi shqiptar ka përcaktuar se thirrja bëhet nëpërmjet njoftimit të letërthirrjesi, duke dorëzuar njoftimin shkresor tek personi i thërritur, kudo ku ai gjendet. Në rast se njoftimi nuk mund të kryhet në këtë mënyrë, ligjvënësi ka përcaktuar alternativat e tjera mbi mënyrën e kryerjes së njoftimit. Nëse njoftimi nuk mund të realizohet në asnjë nga këto mënyra, megjithëse punonjësi i gjykatës ka marrë të gjitha masat e nevojshme për gjetjen e adresës së atij të cilit i destinohet njoftimi, atëherë njoftimi i këtij personi bëhet përmes shpalljes publike.³ Në të njëjtën mënyrë realizohet edhe njoftimi i të gjithë personave që nuk banojnë apo qëndrojnë në Shqipëri, të cilët nuk kanë zgjedhur një banesë apo caktuar një përfaqësues në Shqipëri dhe nuk ka qenë i mundur njoftimi i tij sipas mënyrës së parashikuar nga ligji.⁴

Ky mjet i konsideruar si i fundit për sa i takon njoftimit të palëve në një proces gjyqësor të shkallës së parë, është parashikuar nga ligjvënësi si rregull i përgjithshëm dhe si mjet i parë njoftimi për të gjitha gjykimet në shkallë të dytë, si dhe për gjykimet në Gjykatën e Lartë,⁵ duke e kthyer të drejtën e palëve për t'u mbrojtur apo për të ushtruar të gjitha të drejtat e tyre në një të drejtë iluzive.

¹ Ligj nr. 8417, datë 21.10.1998, Fletore Zyrtare Nr. 28, datë 7.12.1998.

² Vendimi nr. 22, datë 25.04.2023 i Gjykatës Kushtetuese; Vendimi nr. 34, datë 12.6.2023 i Gjykatës Kushtetuese.

³ Ligj nr. 98/2016, datë 6.10.2016, Fletore Zyrtare Nr. 209, datë 7.11.2016.

⁴ Po aty.

⁵ Kalaja, F., *Dilema kushtetuese mbi njoftimin me shpallje publike në gjykimin rishikues*, f. 1. Për më shumë shih:

https://www.academia.edu/47291993/DILEMA_KUSHTETUESE_MBI_NJOFTIMIN_ME_SHPALLJE_N%C3%BB_GJYKIMIN_RISHIKUES, aksesuar online më 15.8.2023.

Korrieri
+355 60 000 0000
keni një letër
nga gjykata
më telefono!

Ky raport, duke trajtuar problematikat e njoftimit me shpallje në gjykimet e natyrës civile apo administrative, në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe në Gjykatën e Lartë, synon ofrimin e disa zgjidhjeve të mundshme të kësaj problematike, duke mbajtur në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe standardet e vendosura nga aktet ndërkombëtare që garantojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore.

2. GJYKIMI RISHIKUES DHE NJOFTIMI

2.1 Gjykimet rishikuese

Ankimi dhe rekursi janë dy mjete të zakonshme të ankimit, të cilat janë në dispozicion të palëve në një proces gjyqësor dhe që mund të përdoren për të goditur gjyqësisht një vendim. Sipas nenit 442/a, të Kodit të Procedurës Civile, ankimi është akti me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës.⁶ Ndërsa për rekursin, Kodi i Procedurës Civile, në nenin 442/b, të tij, jep përkufizimin si vijon: *“Rekursi është akti me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ose të gjykatës së apelit në Gjykatën e Lartë, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod.”*⁷ Këto mjete, në referim të nenit 44, të ligjit nr. 49/2012 *“Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”* janë të njëjta dhe për gjykimet administrative.

2.1.1 Gjykimi në gjykatat e apelit

Në referim të nenit 465/a, të Kodit të Procedurës Civile, gjykimi në apel bëhet mbi bazë aktesh dhe dokumentesh. Në raste përjashtimore, gjykata e apelit vendos kalimin e çështjes në seancë gjyqësore në rast se çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm: (i) për të vlerësuar nëse duhen marrë apo pranuar prova të reja; (ii) kur vë në diskutim çështje të faktit apo ligjit, mbi të cilat palët nuk kanë paraqitur më herët mendimin e tyre.⁸

Rregulli i përgjithshëm është i njëjtë dhe për gjykimet e natyrës administrative. Shqyrtimi i çështjeve të kësaj natyre bëhet në seancë gjyqësore me praninë e palëve, vetëm nëse gjykata konstaton se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar nëse: (i) duhen

⁶ Ligji nr. 8812, datë 17.5.2001, Fletore Zyrtare Nr. 32, datë 12.6.2001.

⁷ Po aty.

⁸ Ligji nr. 38/2017, datë 30.3.2017, Fletore Zyrtare Nr. 98, datë 5.5.2017.

marrë apo pranuar prova të reja; (ii) vendimi ndaj të cilit është bërë ankim është bazuar në shkelje të rënda procedurale apo në gjendjen faktike të konstatuar gabimisht ose jo plotësisht; si dhe (iii) duhet përsëritur marrja e disa ose të gjitha provave.⁹

2.1.2 Gjykimi në Gjykatën e Lartë

Rekursi në Gjykatën e Lartë është një mjet i zakonshëm ankimi, por që mund të ushtrohet vetëm për ato shkaqe, të cilat janë përcaktuar në mënyrë taksative në nenin 472, të Kodit të Procedurës Civile për çështjet me natyrë civile, dhe për çështjet me natyrë administrative vetëm për ato shkaqe të parashikuara në mënyrë të shprehur në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012.

Si rregull, gjykimi në Gjykatën e Lartë, pavarësisht të natyrës së mosmarrëveshjes, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi.¹⁰ Megjithatë, edhe në gjykimin në Gjykatën e Lartë ligjvënësi ka parashikuar disa raste përjashtimore se kur çështja mund të shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

Sipas nenit 482/a, të Kodit të Procedurës Civile, mosmarrëveshja e paraqitur për shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë shqyrtohet në seancë gjyqësore me praninë e palëve atëhere kur thirrja dhe dëgjimi i palëve është i nevojshëm për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, ose kur çështja është me rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësim ose zhvillimin e praktikës gjyqësore.¹¹ Të njëjtat shkaqe parashikohen si arsye për shqyrtimin në seancë gjyqësore edhe për çështjet e natyrës administrative. Në referim të nenit 62, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” një arsye tjetër për shqyrtimin në seancë gjyqësore është dhe rasti kur rekursi bëhet kundër një vendimi që lidhet me aktin nënligjor normativ.

2.2 Rëndësia e njoffimit në gjykimin rishikues

Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj të konsoliduar ka mbajtur qëndrimin se: “Disa standarde kushtetuese janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të

⁹ Ligj nr. 49/2021, datë 23.3.2021, Fletore Zyrtare Nr. 71, datë 14.5.2021.

¹⁰ Ligj nr. 44/2021, datë 23.3.2021, Fletore Zyrtare Nr. 71, datë 14.5.2021; Ligj nr. 49/2021, datë 23.3.2021, Fletore Zyrtare Nr. 71, datë 14.5.2021.

¹¹ Po aty.



tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cënimin e standardeve të tjera.”¹²

Një nga këto standarde, cënimi i të cilit passjell cënimin e standardeve të tjera, është ai i njoffimit të palëve. Dy ndër standardet më të rëndësishme që cënohen përmes mosnjoffimit të palës janë barazia e armëve dhe kontradiktoriteti i procesit.

Njoffimi i rregullt do të respektonte, më së pari, parimin e barazisë së armëve duke i dhënë çdo pale mundësi të barabarta për të paraqitur çështjen e saj.¹³ Në këtë mënyrë, pala që nuk është njoftuar do të jetë në mënyrë të padrejtë më e disavantazuar se pala tjetër. Kjo pasi në një proces gjyqësor, palëve u duhen dhënë mundësi të barabarta për të paraqitur argumente dhe prova në mbështetje të interesave të tyre.¹⁴

Po ashtu, njoffimi do të respektonte dhe parimin e kontradiktoritetit. Sipas këtij parimi, të gjitha palët duhet të kenë mundësinë të jenë në dijeni dhe të komentojnë parashtrimet e paraqitura ose provat e paraqitura nga pala tjetër me qëllim që të ndikohet në vendimin përfundimtar të gjykatës.¹⁵

Këto standarde, në gjykimin rishikues, aplikohen po njësoj si tek shqyrtimi në seancë gjyqësore me praninë e palëve, ashtu dhe në shqyrtimin e çështjeve gjyqësore mbi bazë aktesh dhe/apo dokumentesh. Kështu, Kodi i Procedurës Civile i njeh palëve të drejtën, që deri 5 ditë para datës në të cilën është caktuar seanca e shqyrtimit të çështjes, për të paraqitur parashtrime me shkrim në lidhje me shkaqet e ngritura. Në të njëjtën mënyrë, në fjalinë e tretë, të pikës 2, të nenit 49, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ligjvënësi ka përcaktuar se: “Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim.”¹⁶

Në këtë kontekst, njoffimi merr rëndësi sepse jo vetëm mundëson pjesëmarrjen e palës së njoftuar në procesin gjyqësor përkatës, por edhe i jep asaj mundësi të barabarta për të ngritur pretendime apo për të parashtruar këto pretendime, si dhe për të sjellë prova apo debatuar mbi to.

¹² Vendimi nr.31, datë 26.5.2014 i Gjykatës Kushtetuese; Vendimi nr. 22, datë 25.4.2023 i Gjykatës Kushtetuese.

¹³ Vendim nr. 34, datë 29.5.2015 i Gjykatës Kushtetuese.

¹⁴ Vendim nr. 3, datë 20.1.2017 i Gjykatës Kushtetuese.

¹⁵ Çështja *Zavodnik k. Sillovenisë*, aplikimi nr. 53723/13, datë 21.5.2015.

¹⁶ Ligj nr. 49/2012, datë 3.5.2012, Fletore Zyrtare Nr. 53, datë 16.5.2012.



Korrieri
+355 60 000 0000
keni një letër
nga gjykata
më telefono!

2.3 Rregullimi ligjor i njoftimit me shpallje

Sikundër është trajtuar dhe në hyrje të këtij raporti, në gjykimet në shkallë të parë, qofshin këto të natyrës civile apo administrative, njoftimi me shpallje publike shihet nga ligjvënësi si mjete i fundit përmes të cilit kryhet njoftimi i palëve në një proces. Megjithatë ky rregull nuk vlen për gjykimin në shkallë të dytë dhe në Gjykatën e Lartë, në të cilat, rregulli është se njoftimi i palëve kryhet nëpërmjet shpalljes publike.

Shpallja publike nënkupton afishimin e njoftimit, për jo më pak se njëzet ditë, në ambientet e gjykatës ku zhvillohet gjykimi, si dhe në njësinë administrative ku banon apo qëndron personi.¹⁷

Kështu në referim të nenit 133/a, të Kodit të Procedurës Civile, ky mjet mund të përdoret vetëm në rastet kur: (i) njoftimi nuk është mundur të realizohet me mjetet e tjera, të parashikuara, megjithëse janë marrë të gjitha masat e nevojshme për gjetjen e adresës së personit; (ii) ai, të cilit i drejtohej njoftimi, nuk ka vendbanim, vendqëndrim, nuk ka zgjedhur një banesë ose nuk ka caktuar një përfaqësues në Shqipëri dhe nuk ka qenë i mundur njoftimi i tij sipas një nga mënyrave.¹⁸

Përveç afishimit të njoftimit, për jo më pak se njëzet ditë, në ambientet e gjykatës dhe pranë njësisë administrative ku banon apo qëndron personi, ligjvënësi ka përcaktuar në nenin 133/b, të Kodit të Procedurës Civile, se njoftimi botohet dhe në një rubrikë të posaçme në faqen zyrtare në internet të gjykatës, dhe/ose në një portal elektronik kombëtar të krijuar për qëllime të njoftimit elektronik.¹⁹

2.3.1 Njoftimi me shpallje në gjykatat e apelit

Në gjykimet e natyrës civile, në shkallë të dytë, Kodi i Procedurës Civile parashikon se njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit, duke përfshirë këtu dhe përbërjen e trupit gjykues bëhet nga gjykata e apelit me shpallje në ambientet e saj dhe në gjykatën përkatëse të shkallës së parë. Po ashtu, njoftimi bëhet dhe në faqen e internetit të gjykatës së apelit dhe në faqen e internetit të gjykatës së shkallës së parë. Shpallja duhet të bëhet të paktën 15 ditë para datës së gjykimit. Vetëm në ato raste kur, pala ose përfaqësuesi i saj ka lënë të dhënat elektronike të kontaktit në shkallën e parë, pala ose përfaqësuesi i saj mund të njoftohen individualisht.²⁰

¹⁷ Ligj nr. 38/2017, datë 30.3.2017, Fletore Zyrtare Nr. 98, datë 5.5.2017.

¹⁸ Po aty.

¹⁹ Po aty.

²⁰ Ligj nr. 38/2017, datë 30.3.2017, Fletore Zyrtare Nr. 98, datë 5.5.2017.

Korrieri
+355 60 000 0000
keni një letër
nga gjykata
më telefono!

Në të njëjtën mënyrë është rregulluar dhe njoftimi në gjykimet e natyrës administrative. Kështu, në ligjin nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, ligjvënësi ka përcaktuar në nenin 49, të tij, se shqyrtimi i çështjes si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh dhe për datën dhe orën e shqyrtimit të çështjes, gjyqtari urdhëron njoftimin e palëve sipas rregullave procedurale që përdoren në Gjykatën e Lartë dhe të cilat do të trajtohen në nënseksionin e dytë, të këtij seksioni. Ky njoftim duhet të bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së planifikuar.

Në rast se Gjykata Administrative e Apelit vendos kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve, sipas kushteve të trajtuara më sipër, njoftimi i palëve bëhet sipas të njëjtave rregulla që zbatohen dhe për njoftimin në gjykimin civil në shkallë të dytë.²¹ Ky vendim duhet t’u njoftohet palëve të paktën 10 ditë para datës së zhvillimit të seancës gjyqësore.

2.3.2 Njoftimi me shpallje në Gjykatën e Lartë

Në Gjykatën e Lartë, në referim të pikës 3, të nenit 482, të Kodit të Procedurës Civile, njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e Gjykatës së Lartë, si dhe në faqen e saj të internetit.²² Shpallja bëhet nëpërmjet listës së shqyrtimit të rekurseve, e cila duhet të publikohet të paktën 15 ditë përpara datës së planifikuar për shqyrtim. Vetëm në ato raste kur palët apo përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit në shkallët e tjera, atëhere njoftimi mund të bëhet individualisht.

Po ashtu, në referim të pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, e njëjta mënyrë njoftimi ndiqet dhe për çështjet me natyrë administrative që janë për shqyrtim pranë Gjykatës së Lartë.

2.4 Problemet e njoftimit me shpallje

Një nga arsyet se përse ligjvënësi ka parashikuar njoftimin me shpallje, si rregull mbi njoftimet, në gjykimet në gjykatën e apelit dhe në Gjykatën e Lartë është rritja e efikasitetit në dhënien e drejtësisë, ekonomia gjyqësore, si dhe ofrimi i garancive për një proces brenda

²¹ Ligj nr. 49/2012, datë 3.5.2012, Fletore Zyrtare Nr. 53, datë 16.5.2012.

²² Ligj nr. 38/2017, datë 30.3.2017, Fletore Zyrtare Nr. 98, datë 5.5.2017.

një afati të arsyeshëm, duke mbajtur në konsideratë problematikat që lidhen me sistemin e adresave në Shqipërië.

Korrieri
+355 60 000 0000
keni një letër
nga gjykata
më telefono!

Edhe sipas Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është e mundur që përdorimi i njoftimit me shpallje për fletëthirrjet t'i shërbejë një procesi efikas brenda një afati të arsyeshëm.²³ Megjithatë, kjo mënyrë nuk mund të përdoret në asnjë rast në dëm të garancive të tjera procedurale, veçanërisht në dëm të parimit të barazisë së armëve.²⁴ Gjithashtu, po sipas kësaj Gjykate, nëse aktet gjyqësore, duke përfshirë fletë-thirrjet që përmbajnë datën dhe orën e seancës, nuk dorëzohen personalisht, atëherë një qytetar mund të pengohet të mbrohet në procesin gjyqësor në të cilin është palë.²⁵

Me të drejtë studiuesi dhe magjistrati Florjan Kalaja, duke iu referuar qëndrimit të mbajtur nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut në çështjen *Gakharia k. Gjeorgjisë*, është shprehur se: *"Shpallja si mënyrë publike njoftimi është një masë procedurale ultima ratio, që do të thotë se, vetëm kur gjykata nuk arrin të njoftojë palët sipas mënyrave të zakonshme të njoftimit dhe pasi i ka shteruar të gjitha mjetet e mundshme të njoftimit, vetëm atëherë mundet të procedojë me njoftimin me shpallje."*²⁶

Kjo pasi sipas rregullimeve aktuale, një qytetar, i cili është palë në një proces gjyqësor në shkallë të dytë, duhet të paraqitet në mënyrë periodike pranë ambienteve të gjykatës së shkallës së parë ose atyre gjykatës së apelit për të mësuar datën e caktuar. Megjithatë, është objektivisht e pamundur që një qytetar të paraqitet thuajse çdo ditë pranë ambienteve të gjykatës, qoftë ajo e shkallës së parë, qoftë pranë gjykatës së apelit, për të mësuar mbi fatin e çështjes gjyqësore në të cilën ai është palë.

Një veprim i tillë është sa i pamundur dhe absurd, aq edhe cënues në të drejtën e çdokujt për një proces të rregullt ligjor, duke mbajtur në konsideratë hartën e re gjyqësore, ku një qytetari, çështja e të cilit është gjykuar në shkallë të parë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet, tani më do t'i nevojitet të interesohet pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Përmet ose pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, me seli në Tiranë.

Po ashtu, për të kontrolluar nëse për një çështje ndaj të cilës është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë ka apo jo seancë të planifikuara, palët, pavarësisht vendndodhjes së tyre duhet të paraqiten në Tiranë, për të verifikuar njoftimet e shpallura në ambientet e kësaj gjykate.

²³ Çështja *Gakharia k. Gjeorgjisë*, aplikimi nr. 30459/13, datë 17.1.2017.

²⁴ Po aty.

²⁵ Çështja *Ozgur-Karaduman k. Gjermanisë*, aplikimi nr. 4769/02, datë 26.6.2007; Çështja *Dilipak dhe Karakaya k. Turqisë*, aplikimet nr. 7942/05 dhe 24838/05, datë 4.3.2014.

²⁶ Kalaja, F., *Dilema kushtetuese mbi njoftimin me shpallje publike në gjykimin rishikues*, f. 7.

Korrieri
+355 60 000 0000
keni një letër
nga gjykata
më telefono!

Megjithëse si në gjykimin në shkallë të dytë, ashtu dhe në Gjykatën e Lartë, njoftimet shpallen edhe në faqet zyrtare të internetit, sërish nuk mund të pretendohet që një qytetar të verifikojë çdo ditë, në mënyrë periodike, për një kohë të pacaktuar, nëse ka apo jo ndonjë seancë të planifikuar për çështjen në të cilën është palë.

Duke mbajtur në konsideratë numrin e lartë të stokut të dosjeve si në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, ashtu dhe në Gjykatën e Lartë, qytetarët janë të detyruar që të kontrollojnë në mënyrë periodike, ditë për ditë, për ndoshta të paktën tre apo katër vite, pa ndërpreje, me qëllim që të shohin nëse për çështjen në të cilën ata janë palë është caktuar ndonjë seancë apo jo. Kjo pritje, e cila për shkak të stokut është aktualisht më e madhe në kohë sesa afatet procedurale të parashikuara për gjykimin e mosmarrëveshjeve, është e pajustificuar dhe përbën një barrë të rënduar kundrejt palëve në proces.

Një tjetër problem që lidhet me njoftimin në gjykimet rishikuese është fakti se njoftimi i palëve mund të bëhet individualisht, vetëm në ato raste kur pala ose përfaqësuesi i saj kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit në shkallën e parë të gjykimit.²⁷ Ky parashikim në formën aktuale është jologjik, pasi i heq mundësinë palës që, përmes komunikimeve që ajo ka me gjykatën, duke depozituar ankimin apo rekursin apo akte të tjera, t'i përcjellë gjykatës edhe kontaktet e saj elektronike. Madje dhe në ato raste, kur pala ja përcjell këto të dhëna gjykatës me aktet e mëpasshme, sipas rregullimeve aktuale, gjykata nuk mund ta njoftojë individualisht palën ose përfaqësuesin e saj për aq kohë sa ajo nuk i ka njoftuar të dhënat e saj në shkallë të parë, të cilat, për shkak të kalimit të kohës, mund të ndryshojnë.

Po ashtu, megjithëse ligjvënësi ka parashikuar në nenin 133/b, të Kodit të Procedurës Civile, krijimin e një portali elektronik kombëtar për efekt të njoftimeve elektronike, aktualisht nuk është ndërmarrë asnjë hap me qëllim përmbushjen e këtij detyrimi ligjor, duke ndikuar kështu në krijimin e premisave për cënimin e të drejtës për proces të rregullt ligjor për të gjithë qytetarët, që janë palë në procese gjyqësore në shkallë të dytë apo në Gjykatën e Lartë.

3. GJYKATA KUSHTETUESE PËRBALLË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

Më 12 qershor 2023, pasi mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentash çështjen e parashtruar nga një qytetare, e cila, ndër të

²⁷ Ligj nr. 38/2017, datë 30.3.2017, Fletore Zyrtare Nr. 98, datë 5.5.2017.

Korrieri
+355 60 000 0000
keni një letër
nga gjykata
më telefono!

tjera, kërkonte dhe shfuqizimin e dispozitave që përcaktonin detyrimin për shpalljen e listave të shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit të çështjes nga ana e sekretarisë së Gjykatës së Lartë dhe të njoftimit me shpallje, Gjykata Kushtetuese vendosi se pretendimi për cënimin e të drejtës së aksesit në gjykatë në lidhje me të drejtën për mbrojtje efektive ishte i pabazuar duke gjetur kështu në përputhje me Kushtetutën e Shqipërisë njoftimin me shpallje në Gjykatën e Lartë.²⁸

Megjithatë pasi kishin kaluar 8 ditë nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese, më datë 20.06.2023, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në çështjen *Lazaris kundër Shqipërisë*, vendosi se mungesa e njoftimit për të marrë pjesë në seancën gjyqësore përpara Gjykatës së Lartë, bie ndesh me garancitë e procesit të rregullt ligjor që ofron neni 6 i KEDNJ, të drejtën për t'u dëgjuar e mbrojtur, si dhe parimin e barazisë së armëve.²⁹

3.1 Gjykata Kushtetuese mbi njoftimin me shpallje në Gjykatën e Lartë

Pretendimin e kërkueses se, njoftimi me shpallje nënkupton se ajo duhet të kalonte te stenda e Gjykatës së Lartë çdo ditë përreth 4 vjet³⁰ dhe të kërkonte çdo ditë në internet nëse çështja e saj është njoftuar me shpallje për gjykim ose jo, përbënte një barrë shumë të rëndë dhe aspak proporcionale për të, si dhe ishte objektivist e pamundur të realizohej praktikisht, veçanërisht kur fluksi i njoftimeve në Gjykatën e Lartë ishte me dhjetëra çdo ditë, Gjykata Kushtetuese, çuditërisht, e gjeti të pabazuar.

Në vendimin e saj Gjykata Kushtetuese, ndër të tjera duke iu referuar njoftimit me shpallje, është shprehur se: *"Kjo masë nuk duket se vendos ndonjë barrë të tepërt për individin, palë në procesin gjyqësor, duke qenë se detyrimi për publikimin e njoftimeve në faqen e internetit të gjykatës, përveç atij për shpalljen në ambientet fizike të saj, shoqërohet edhe me mundësinë e njoftimit individual, kur vetë individi depoziton të dhënat elektronike të kontaktit të tij."*³¹

Në lidhje me pretendimin e kërkueses se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar personalisht, ndonëse ajo kishte dhënë numrin e saj të telefonit

²⁸ Vendimi nr. 34, datë 12.6.2023 i Gjykatës Kushtetuese.

²⁹ Çështja *Lazaris kundër Shqipërisë*, aplikimi nr. 48806/06, datë 20.6.2023.

³⁰ Në referim të fakteve dhe pretendimeve të pasqyruara në vendimin nr. 34, datë 12.6.2023 të Gjykatës Kushtetuese, rezulton se çështja e kërkueses ishte regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 26.12.2018 dhe ishte shqyrtuar në datën 16.06.2022, në tejkallim të afatit 90-ditor të përcaktuar nga neni 60, pika 2, i ligjit nr. 49/2012.

³¹ Vendimi nr. 34, datë 12.6.2023 i Gjykatës Kushtetuese.

Korrieri
+355 60 000 0000
keni një letër
nga gjykata
më telefon!

celular, Gjykata Kushtetuese: "(...) vëren se bazuar në nenin 141 të KPC-së, zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë ka nxjerrë urdhri administrativ nr. 131, datë 02.07.2021 "Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve" (urdhri administrativ nr. 131/2021), në pikën 5 të të cilit parashikohet se kur sekretaria gjyqësore konstaton se palët kanë deklaruar si të dhënë kontakti adresën e postës elektronike (e-mail), duhet të bëjë edhe njoftimin elektronik për datën e gjykimit. Në vlerësimin e Gjykatës, njoftimi elektronik është një alternativë e re ligjore, përdorimi i së cilës duhet nxitur, pasi i përgjigjet jo vetëm nevojës për shpejtësi në procedura, por edhe problematikave të shfaqura në jetën e përditshme nga lëvizjet demografike dhe sistemi ende i pakonsoliduar i adresave të qytetarëve. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se kërkuesja ka depozituar vetëm numrin e telefonit celular, i cili nuk përfshihet në konceptin e të dhënës së kontaktit "adresë e postës elektronike", referuar përmbajtjes së urdhrit administrativ nr. 131/2021 të zëvendëskryetarit të Gjykatës së Lartë. Në kushtet kur ajo nuk ka deklaruar në aktet drejtuar Gjykatës së Lartë adresën e postës elektronike të saj, atëherë Gjykata çmon se pretendimi i saj është i pabazuar."³²

Megjithëse gjyqtari në pakicë pajtohet në lidhje me qëndrimin e shumicës mbi kushtetueshmërinë e njoftimit me shpallje, ai kundërshton konceptin e mjetit elektronik të njoftimit të bërë nga shumica, që përjashton prej këtij koncepti telefonin celular. Sipas gjyqtares Marsida Xhaferllari: "Gjykata duhej t'u përgjigjej këtyre zhvillimeve dhe të pranonte se numri i telefonit celular përbën mjet komunikimi elektronik, sepse ai mundëson komunikimin e menjëhershëm të të dhënave nga njëri përdorues tek tjetri nëpërmjet mesazheve, por edhe nëpërmjet platformave sociale. Si i tillë, ai është pajisje e komunikimit elektronik, sepse shërben nga ana teknike për emetimin, transmetimin, rrugëzimin, komutimin dhe/ose marrjen e sinjaleve nëpërmjet valëve elektromagnetike. Në vlerësimin tim, ideja se komunikimi elektronik përfshin vetëm komunikimin me anë të postës elektronike është e varfër dhe nuk u përgjigjet zhvillimeve të sotme të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (sikurse njihet në përditshmëri "TIK"), të cilat garantojnë sigurimin e aksesit në informacione përmes telekomunikimit, përfshirë këtu internetin, celularët ose media të tjera komunikimi. Përdorimi i këtyre mjeteve i ka dhënë tashmë një dimension të ri ndërveprimit njerëzor, pasi nxit, realizon dhe motivon në kohë reale komunikimin dhe informimin për çështje që paraqesin rëndësi për individin dhe prekin interesat e tij, veçanërisht në

³² Po aty.

procedura që ndryshojnë situatën juridike në raport me të drejtat dhe liritë themelore të tij. Nën këtë optikë, shmangia e disa mjeteve të komunikimit, të cilat janë të gjerësisht përdorshme nga individit, përbën një barrierë të ngurtë dhe të pakuptimtë.”³³

3.2 GJEDNJ mbi njoffimin me shpallje në Gjykatën e Lartë

Megjithëse njoffimi me shpallje në Gjykatën e Lartë i rezistoi testit të kushtetueshmërisë në Gjykatën Kushtetuese, vetëm tetë ditë më pas, i njëjti mjet njoffimi u konsiderua se binte ndesh me garancitë e procesit të rregullt që ofron neni 6 i Konventës Evropiane, dhe veçanërisht me të drejtën për t’u mbrojtur dhe me parimin e barazisë së armëve.

Në ndryshim nga Gjykata Kushtetuese, e cila përcaktoi se kontrollimi i faqes zyrtare të gjykatës dhe ambienteve të saj në mënyrë periodike, ditore, për një kohë të pacaktuar, nuk përbënte ndonjë barrë të rëndë për qytetarin, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut u shpreh se nuk mund të pritet që veprime të tilla të kryheshin për çdo njoffim të seancave të publikuara nga Gjykata e Lartë pasi kishte kaluar rreth një gjysmë viti nga momenti që palët ishin njohur me rekursin.³⁴

Po ashtu, Gjykata ritheksoi qëndrimin se se, edhe nëse palët tregojnë një mungesë të caktuar kujdesi, pasojat që i atribuohen sjelljes së tyre nga gjykatat vendase duhet të jenë në përpjesëtim me peshën e neglizhencës së palës dhe duhet të marrin parasysh parimin e të drejtës për t’u dëgjuar.³⁵

Duke vërejtur se nuk kishte asnjë tregues që të demonstronte se nga ana e Gjykatës së Lartë ishte kryer ndonjë përpjekje për të njoftuar avokatin e palës, identiteti i të cilit është i njohur, bashkë me adresën e tij, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut konstatoi dhe njëherë se njoffimi me shpallje duhet përdorur nga ana e gjykatave si mjeti i fundit i njoffimit, në ndryshim nga rregulli i vendosur nga ligjvënësi shqiptar në gjykimet rishikuese.

³³ Vendimi nr. 34, datë 12.6.2023 i Gjykatës Kushtetuese.

³⁴ Çështja *Lazaris kundër Shqipërisë*, aplikimi nr. 48806/06, datë 20.6.2023.

³⁵ Po aty.

Korrieri
+355 60 000 0000
keni një letër
nga gjykata
më telefono!

Korrieri
+355 60 000 0000
keni një letër
nga gjykata
më telefono!

REKOMANDIME

Pavarësisht analizave dhe gjetjeve të drejta nga studiuesit, tashmë me një vendim të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut kundër Shqipërisë përsa i takon procesit të njoftimeve në Gjykatën e Lartë, Kuvendi i Shqipërisë duhet të marrë të gjitha masat për ndryshimet e nevojshme ligjore duke e sanksionuar njoftimin me shpallje, si mjet të fundit, të aplikueshëm vetëm atëhere kur çdo mënyrë tjetër komunikimi nuk rezulton e suksesshme dhe palës nuk i gjendet asnjë adresë apo mjet komunikimi, edhe në gjykimet në shkallë të dytë dhe në Gjykatën e Lartë, njësoj sikurse parashikohet për gjykimet në shkallë të parë.

Po ashtu, ndryshimet legjislative duhet të kenë në fokus dhe të pranojnë si një nga mënyrat e njoftimit, edhe njoftimin nëpërmjet numrit telefonik, duke kërkuar që në rast të përdorimit të kësaj metode, të mbahet një procesverbal i posaçëm, në të cilin të pasqyrohen të dhënat e nevojshme, sipas modelit ekzistues, të parashikuar në nenin 22, të ligjit nr. 49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative".

Gjithashtu, përveç përmirësimit të kuadrit ligjor ekzistues, nevojitet dhe përbushja e detyrimeve ligjore që rrjedhin prej këtij kuadri ligjor. Kështu, organet përgjegjëse duhet të ndërtojnë portalin elektronik kombëtar, i cili, mund të lidhet me sistemin unik qeveritar, duke mundësuar kështu dhe njoftimin përmes këtij portali, nën të njëjtën mënyrë që mund të bëhet dhe gjurmimi i çështjeve gjyqësore.

BIBLIOGRAFIA

Korrieri
+355 60 000 0000
keni një letër
nga gjykata
më telefono!

- Çështja Dilipak dhe Karakaya k. Turqisë, aplikimet nr. 7942/05 dhe 24838/05, datë 4.3.2014;
- Çështja Gakharia k. Gjerogjisë, aplikimi nr. 30459/13, datë 17.1.2017;
- Çështja Lazaris kundër Shqipërisë, aplikimi nr. 48806/06, datë 20.6.2023;
- Çështja Ozgur-Karaduman k. Gjermanisë, aplikimi nr. 4769/02, datë 26.6.2007;
- Çështja Zavodnik k. Sllovenisë, aplikimi nr. 53723/13, datë 21.5.2015;
- Florjan Kalaja, *Dilema kushtetuese mbi njoftimin me shpallje publike në gjykimin rishikues*. Për më shumë shih: https://www.academia.edu/47291993/DILEMA_KUSHTETUESE_MBI_NJOFTIMIN_ME_SHPALLJE_N%C3%8B_GJYKIMIN_RISHIKUES
- Ligj nr. 44/2021, datë 23.3.2021, Fletore Zyrtare Nr. 71, datë 14.5.2021;
- Ligj nr. 38/2017, datë 30.3.2017, Fletore Zyrtare Nr. 98, datë 5.5.2017;
- Ligj nr. 49/2012, datë 3.5.2012, Fletore Zyrtare Nr. 53, datë 16.5.2012;
- Ligj nr. 49/2021, datë 23.3.2021, Fletore Zyrtare Nr. 71, datë 14.5.2021;
- Ligj nr. 8417, datë 21.10.1998, Fletore Zyrtare Nr. 28, datë 7.12.1998;
- Ligj nr. 8812, datë 17.5.2001, Fletore Zyrtare Nr. 32, datë 12.6.2001;
- Ligj nr. 98/2016, datë 6.10.2016, Fletore Zyrtare Nr. 209, datë 7.11.2016;
- Vendim nr. 3, datë 20.1.2017 i Gjykatës Kushtetuese;
- Vendim nr. 34, datë 29.5.2015 i Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr. 22, datë 25.04.2023 i Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr. 34, datë 12.6.2023 i Gjykatës Kushtetuese;
- Vendimi nr.31, datë 26.5.2014 i Gjykatës Kushtetuese;

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al